



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.101/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në shtylla elektrike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2,700.00 (dymijë e shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e marrjes-pranimi të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Paneli, me datën 06.06.2017, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, në Rrugën “Tranziti Brigada 123” në Komunën e Therandës, aktivisti i tyre ka vërejtur posterin e kandidatit për deputet Nexhat Ramadani nga koalicioni LDK-AKR e vendosur nëpër shtylla elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se koalicioni LDK-AKRj me vendosjen e posterit të kandidatit të saj në shtylla elektrike, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4 par.1 pika (b), të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 dhe nenit 3 par.4 të Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2014 vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës i ka prezantuar PZAP-it, një fotografi nga vendi ku është vendosur posterit i kandidatit në fjalë.

Koalicioni LDK-AKR, në përgjigje në ankesë të datës 08.06.2017, thekson se me të marrë urdhërin për masat e përmirësimit nga PZAP-i, lidhur me rastin Anr.101/2017 të datës 06.06.2017, i kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, duke i larguar posterët e kandidatit në fjalë, nga vendet ku ishin të vendosura. Me propozim për PZAP-i, që të mos i shqiptojë gjobë subjektit politik me faktin se janë larguar posterët nga kandidati.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, te cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se dy postert e kandidatit për deputet Nexhat Ramadani, nga radhët e Koalicionit LDK-AKR, është vendosur në shtyllë elektrike e cila çështje nuk është mohuar as nga përgjigja në ankesë e Koalicionit LDK-AKR.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se koalicioni i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike”*

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterat e kandidatit për deputet nga ky koalicion janë vendosur në hapsirë publike, gjegjësisht në shtylla elektrike, po ashtu e njëjta shkelje nga ky koalicion është përsëritur disa herë në këto zgjedhje.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftu me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është përsëritur vazhdimisht gjatë këtij procesi zgjedhor dhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatit për deputet nga ky koalicion është i vendosur në shtylla elektrike.

Paneli poashtu vlerësoi me rastin e vendosjes, lidhur me gjobën e shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, përpjekjet e koalicionit LDK-AKR, i cili ka ndërmarrë masa përmirësuese për evitimin e shkeljes së kodit të mirësjelljes, duke i larguar posterat nga vendi që ishin të vendosur, me çka konstatohet nga fotografia e ofruar si provë që gjenden në shkresat e

lëndës, të cilat masa përmirësuese kanë ndikuar në vendim-marrje, me rastin e shqiptimit të gjobës.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa

Anr.101/2017 më datën 09.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*